



**BASHKIA MIRDITË  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1698/2 Prot.

Rrëshen më, 10 . 05 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 42 datë 10. 05. 2024**

**PËR**

**“DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KALIMIN NË PRONËSI TË PARCELAVE TË NDODHURA NË ZONËN KADASTRALE 3224 ME SIPËRFAQE PREJ; 42 498 M2 (4.2498 HA) E LLOJIT TOKË TRUALL DHE TROTUAR, NGA MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT NË BASHKINË MIRDITË, PËR NDËRTIMIN E STACIONIT ZJARRFIKËS TË BASHKISË MIRDITË”.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.2 shkronja “a”, nenit 54 shkronja “e” të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 1, shkronjat “ç” dhe “dh”, neni 23 pika 28, neni 15 pika 1.2.2, ligjit 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të Shtetit në njësitë e Qeverisjes Vendore”, me të gjitha ndryshimet, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 04.03.2004 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit”, me të gjitha ndryshimet, ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), neni 23 pika 4, shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave me nr. 113/1 prot 07.02.2024 “Përgjigje shkresës Tuaj nr. 409 prot, datë 29.01.2024” si dhe relacionin me nr. 1698 prot, datë 26.04.2024, së bashku me projekt –vendimin e paraqitur nga kryetari i bashkisë (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit), në këshillin bashkiak, pas diskutimeve në mbledhjen e anëtarëve të këshillit bashkiak,

**V E N D O S I:**

- Miratimin për “Dhënie e pëlqimit për kalimin në pronësi të parcelave me sipërfaqe prej; 42 498 m<sup>2</sup> (4.2498 ha) e llojit tokë truall dhe trotuar, nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkinë Mirditë, për ndërtimin e Stacionit Zjarrfikës të bashkisë Mirditë.
  - Pronat që jepet pëlqimi për kalim në pronësi në bashkinë Mirditë, kanë një sipërfaqe prej; 42 498 m<sup>2</sup> (4.2498 Ha), dhe specifikohen në tabelën si më poshtë vijon:

Nr. pas	Zona Kadastrale	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja e përgjithshme e pronës (m <sup>2</sup> )
4/62	3224	Trotuar	1 376.7
4/11	3224	Truall	5 851.1
4/61	3224	Trotuar	1 145.5
4/56	3224	Truall	34 124.7
			<b>42 498</b>

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

2. Relacioni nr. 1698 prot, datë 26.04.2024, planet e rilevimit Sh 1: 500, me indeks htr RRE-B-3, shkresën e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me nr. 1548/8 prot, datë 15.11.2022, shkresën “Kërkesë për donacion” e bashkisë Mirditë me nr. 4876/1 prot, datë 30.11.2022, shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave me nr. 113/1 prot 07.02.2024, “Përgjigje shkresës Tuaj nr. 409 prot, datë 29.01.2024”, shkresa në versionin elektronik, datë 23.03.2024 e Agjencia Shtetërore e Kadastrës, si dhe formular për inventarin e pronave të paluajtshme shtetërore, *bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi.*
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë (drejtoria e planifikimit, zhvillimit të territorit dhe agjencia e inspektimit, kontrollit dhe emrgjencave).

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**SEKRETAR**

**Gaspër TOPOLLAJ**



**KRYETAR**

**Aleksandër PICA KU**





**BASHKIA MIRDITË  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1698/1 Prot.

Rrëshen më, 26.04. 2024

**P/VENDIM**

Nr. 53 datë 26.04. 2024

**PËR**

**“DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KALIMIN NË PRONËSI TË PARCELAVE TË  
NDODHURA NË ZONËN KADASTRALE 3224 ME SIPËRFAQE PREJ 42 498 M2 (4.2498  
HA) E LLOJIT TOKË TRUALL DHE TROTUAR, NGA MINISTRIA E EKONOMISË,  
KULTURËS DHE INOVACIONIT NË BASHKINË MIRDITË, PËR NDËRTIMIN E  
STACIONIT ZJARRËFIKËS TË BASHKISË MIRDITË.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.2 shkronja “a”, nenit 54 shkronja “e” të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 1, shkronjat “ç” dhe “dh”, neni 23 pika 28, neni 15 pika 1.2.2, ligjit 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të Shtetit në njësitë e Qeverisjes Vendore”, me të gjitha ndryshimet, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 04.03.2004 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit”, me të gjitha ndryshimet, ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), neni 23 pika 4, shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave me nr. 113/1 prot 07.02.2024 “Përgjigje shkresës Tuaj nr. 409 prot, datë 29.01.2024” si dhe relacionin me nr. 1698 prot, datë 26.04.2024, sëbashku me projekt –vendimin e paraqitur nga kryetari i bashkisë (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit), në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak në seancë,

**V E N D O S I:**

1. “Dhënie e pëlqimit për kalimin në pronësi të parcelave me sipërfaqe prej 42 498 m<sup>2</sup> (4.2498 Ha) e llojit tokë truall dhe trotuar, nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në Bashkinë Mirditë, për ndërtimin e Stacionit Zjarrëfikës të Bashkisë Mirditë.
- Pronat që jepet pëlqimi për kalim në pronësi në bashkinë Mirditë kanë një sipërfaqe prej 42 498 m<sup>2</sup> (4.2498 Ha), dhe specifikohen në tabelën si vijon:

Nr. pas	Zona Kadastrale	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja e përgjithshme e pronës (m <sup>2</sup> )
4/62	3224	Trotuar	1376.7
4/11	3224	Truall	5851.1
4/61	3224	Trotuar	1145.5
4/56	3224	Truall	34124.7
			<b>[42 498</b>

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

2. Bashkëlidhur relacioni nr. \_\_\_\_\_ prot, datë \_\_\_\_\_.02.2024, planet e rilevimit Sh 1: 500 dhe Sh 1: 2000, me indeks htr RRE – B – 3, si dhe shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave me nr. 113/1 prot 07.02.2024 “Përgjigje shkresës Tuaj nr. 409 prot, datë 29.01.2024”, shkresën e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me nr. 1548/8 prot, datë 15.11.2022, shkresën “Kërkesë për donacion” e bashkisë Mirditë me nr. 4876/1 prot, datë 30.11.2022 si dhe shkresa nr. \_\_\_\_\_ prot, datë \_\_\_\_\_.02.2024 e Zyrës Vendore AShK Mirditë.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë (DPZHT dhe AIKE).

*Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(të ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

*Paraqiti Projektin:*

P/Spektori MZSh Bashkia Mirditë:

Agim LLESHAJ

P/Spektori Zhvillimit Territorit dhe Ap. Lejeve: Ing. Blenard DUDI

Spektori i Emergjencave Civile:

Ing. Mëhill PAÇUKU

Drejtori i Planifikimit Zhvillimit Territorit:

Ing. Genc VLADI

Drejtori Juridik:

Besian DEDAJ

**KRYETARI**

**Albert MËLYSHI**





## BASHKIA MIRDITË

Nr. 1698 Prot.

Rrëshen, më 26 .04 .2024

Lënda : **Relacion mbi projektin për “Dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të parcelave të ndodhura në zonën kadastrale 3224 me sipërfaqe prej 42 498 m<sup>2</sup> (4.2498 ha) e llojit tokë truall dhe trotuar, nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në Bashkinë Mirditë, për ndërtimin e stacionit zjarrëfikës të Bashkisë Mirditë”**

Drejtuar: **KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË,**

**Të nderuar këshilltarë!**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.2 shkronja “a”, nenit 54 shkronja “e” të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 1, shkronjat “ç” dhe “dh”, neni 23 pika 28, neni 15 pika 1.2.2, ligjit 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të Shtetit në njësitë e Qeverisjes Vendore”, me të gjitha ndryshimet, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 04.03.2004 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit”, me të gjitha ndryshimet, ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), neni 23 pika 4, shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave me nr. 113/1 prot 07.02.2024 “Përgjigje shkresës Tuaj nr. 409 prot, datë 29.01.2024” mbi projektin për “Dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të parcelave të ndodhura në zonën kadastrale 3224 me sipërfaqe prej 42 498 m<sup>2</sup> (4.2498 ha) e llojit tokë truall dhe trotuar, nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në Bashkinë mirditë, për ndërtimin e stacionit zjarrëfikës të Bashkisë Mirditë”, vijmë para jush për të kërkuar pëlqimin për pronat:

Nr. pas	Zona Kadastrale	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja e përgjithshme e pronës (m <sup>2</sup> )
4/62	3224	Trotuar	1376.7
4/11	3224	Truall	5851.1
4/61	3224	Trotuar	1145.5
4/56	3224	Truall	34124.7
			<b>[42 498</b>

Këto prona do të shërbejnë për ndërtimin e këtij stacioni zjarrefikës i cili do të financohet nga O.D.C (Office of Defense Cooperation/Zyra për Mbrojtje dhe Bashkëpunim) dhe Ambasada Amerikane në Shqipëri. Ndërtimi i në stacioni të ri Zjarrëfikës me kushte bashkëkohore paraqet një rëndësi të veçantë për rritjen e efikasitetit dhe shërbimit në territorin e bashkisë Mirditë si dhe në aksin rrugor kombëtar “Rruga e Kombit E851”. **Theksojmë që një pjesë e pronës do të përdoret për rrugë aksesi**

ADRESA: SHESHI “ABAT DOCI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

hyrje/dalje si dhe të gjitha parcelat do të vihen në dispozicion të projektuesve të kontraktuar nga O.D.C.

Ky financim është kërkuar nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) ku bashkëlidhur këtij relacioni do të gjeni edhe komunikim shkresorë për këtë projekt.

Gjithashtu bashkëlidhur do të gjeni edhe hartat treguese për pronat e mësipërme që kërkohet pëlqimi për vijimin me sukses të procedurave vijuese.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

P/Spektori MZSh Bashkia Mirditë:

Agim LLESHAJ

P/Spektori Zhvillimit Territorit dhe Ap. Lejeve: Ing. Blenard DUDI

Spektori i Emergjencave Civile:

Ing. Mëhill PAÇUKU

Drejtori i Planifikimit Zhvillimit Territorit:

Ing. Genc VLADI

Drejtori Juridik:


Besian DEDAJ

**KRYETARI**

**Albert MËLYSHI**








PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

INTERESARI: ZYSHK MIRIDITË  
 QELIMI: MARRJE NË PRANË  
 INDENSI HARTE: ABE - B - J  
 FORMAT: A0  
 SIP: 34124.7 m<sup>2</sup>  
 KORRIZA REFERUESE GJEDOZKE SHOPTARE

DATE: 06.03.2024  
 ZONA KADASTRALE: 3224  
 NR PASURISE: 4/11

REALIZUAR: ZYSHK MIRIDITË  
 VERIFIKUAR: MR PASURISE 4/11  
 DATE: 06.03.2024



Legjenda: MR224RR\_P

NR	PROJEKTI	IPR	STATUSI	EDRPI	SPACIMI	TEKSTI
1	1	1	1	1	1	1
2	2	2	2	2	2	2
3	3	3	3	3	3	3
4	4	4	4	4	4	4

REALIZUAR: ZYSHK MIRIDITË  
 VERIFIKUAR: MR PASURISE 4/11  
 DATE: 06.03.2024

INTERESARI: ZYSHK MIRIDITË  
 QELIMI: MARRJE NË PRANË  
 INDENSI HARTE: ABE - B - J  
 FORMAT: A0  
 SIP: 34124.7 m<sup>2</sup>  
 KORRIZA REFERUESE GJEDOZKE SHOPTARE

REALIZUAR: ZYSHK MIRIDITË  
 VERIFIKUAR: MR PASURISE 4/11  
 DATE: 06.03.2024

INTERESARI: ZYSHK MIRIDITË  
 QELIMI: MARRJE NË PRANË  
 INDENSI HARTE: ABE - B - J  
 FORMAT: A0  
 SIP: 34124.7 m<sup>2</sup>  
 KORRIZA REFERUESE GJEDOZKE SHOPTARE



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

I INTERESUARI/  
BASHKIA MIRDITË

DATË 06.03.2024

QELIMI: MARRJE NË PRONËSI

VENDNDODHJA  
BASHKIA MIRDITË

ZV ASHK MIRDITË

ZONA KADASTRALE 3224

NR PASURISE 4/61

INDEKS HARTE: RRE - B - 3

TE DHENAT E PASURISE  
LLOJI I PASURISE "TROUAR"

SIP: 1145.5 m<sup>2</sup>  
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

FORMAT A1  
SH 1: 500



Legjenda:

MR3224RR/P

Nr.	ORIENTIMI	PEROORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	IDINIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	V	4/56				
2	J	4/11				
3	L	4/56				
4	P	4/11				

REALIZOHET:  
REALIZOHET PER ASHK  
SPECIALISTI  
ZV ASHK MIRDITË  
NENSHKRIMI

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, Z, O, G, D  
Kode per teknologjine e matjeve: T-Teren; Z-Zyre; O-Orofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Mateje Distancash  
PERCAKTIMI I KUFIRIT:  
Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i pronarve; K-Kultaret te gjithe; KP-Kultare pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale;  
SHENIME TE VECANTA:  
Pasuria nr. 4/61 me sipërfaqe 1145.5 m<sup>2</sup> e llojit trotuar. Kërtohet për marrje në pronësi nga Bashkia Mirditë me qëllim përdorimin e kesaj sipërfaqe në funksion të ndërrimit të Stacionit të MZSH. Prona i përket Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.  
Kufizimet e pasurisë janë treguar në terren nga i interesuari  
PRONARI/BASHKËPRONARËT-DEKLARIM MBI MARRDHENIET ME KUFITARET  
I INTERESUARIT:  
P/SEKT MZSH MIRDITË  
AGIM LLESHAJ  
NENSHKRIMI

REALIZOHET:  
TOP GUJON LLESHAJ  
NR. LIC. T. 1517/11, DATE 12.10.2020  
NENSHKRIMI

ING. BLEHARD DUDI  
NR. LIC. T. 0343/4, DATE 07.2017  
NENSHKRIMI



KONFIRMUOHET:  
DREJTORI I PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT  
ING. GJENO VLADI

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Teren; Z-Zyre; O-Orofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Mateje Distancash; P-Perfaqesues i pronarve; K-Kultaret te gjithe; KP-Kultare pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale.



Udhëzimet  
Gjenerale

✓ Nr. 4876 Prot  
Dt. 18.11.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE



Nr. 1548/18 Prot.

Tiranë, më 15.11.2022

Lënda: Kërkesë për bashkëpunim.

**BASHKISË MIRDITË**

Mirditë

Për dijeni:

**PREFEKTURËS LEZHË**

Lezhë

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në bashkëpunim me zyrën e Office of Defence Cooperation (ODC) pranë Ministrisë së Mbrojtjes në Tiranë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, bazuar shkresës nr. 1548/1, datë 22.09.2022” Për Evidentimin e Nevojave dhe Forcimin e Kapaciteteve të MZSH”, pas inspektimit të kryer, bashkia Mirditë është përzgjedhur si përfituese e këtij programi për ndërtimin e një stacioni zjarrfikës dhe rritjen e kapaciteteve logjistike.

Për sa më sipër, si dhe bazuar në ligjin nr.45, datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile” dhe në VKM nr.923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e Organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe Bashkëpunimin Ndërinstitucional të Institucioneve dhe Strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile”, dhe pas diskutimit me përfaqësuesit e O.D.C, me qëllim vijimin e këtij projekti, kërkojmë nga ana e institucionit tuaj:

- ① Kërkesë për donacion drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, ku të përshkruhet gjendja aktuale e stacionit zjarrfikës dhe arsyen pse duhet ndërtuar ky stacion zjarrfikës.
- ② Projekt propozim i godinës, bashkëlidhur preventiv i punimeve për ndërtimin e stacionit.
- ③ Deklaratë nëpërmjet të cilës bashkia garanton të planëzojë fonde për rimbursimin e TVSH-së.
- ④ Certifikatë e pronësisë së tokës ku do të ndërtohet stacioni zjarrfikës.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.





## BASHKIA MIRDITË

Nr. 4876 / Prot.  
1

Rrëshen, me 30/11/2022

**Lënda:** Kërkesë për donacion

### AGJENCISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE ADRESA: Rruga "Skënderbeg" Tiranë

Referuar shkreses tuaj datë 15/11/2022 protokolluar me tonën datë 18/11/2022 me nr. 4876 protokoll, po ju përshkruajmë si më poshtë gjendjen aktuale të stacionit zjarrfikës të bashkisë Mirditë:

Stacioni zjarrfikës gjendet në mjediset e Komisarariatit Mirditë, i veçuar me një hyrje të ngushtë dhe të pa përshtatshme nga rruga kryesore pasi kufizohet direkt me godinën e Gjimnazit Rrëshen. Vetë stacioni ka një sipërfaqe prej 70 m<sup>2</sup> i sajuar mbi ish garazhdin e komisarariatit Mirditë. Garazhdet kanë një sipërfaqe të vogël dhe lartësi jo të mjaftueshëm për stacionimin e mjeteve zjarrfikëse që janë vetëm dy garazhde çka bën të pamundur të akomodohen të gjithë mjeteve zjarrfikëse që bashkia disponon. Njëra nga mjetet zjarrfikëse qëndron në oborrin e stacionit zjarrfikës, ndërsa dy automjete të tjera qëndrojnë jashtë stacionit. Gjendja konstruktive e objektit është e vjetër dhe tejet e amortizuar. Dhomat e qëndrimit të stafit dhe personelit ndodhen në katin e dytë ku aksesimi është nëpërmjet një shkalle të improvizuar metalike të papërshtatshme.

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana Juaj mundësinë e financimit të një stacioni të ri zjarrfikës pasi stacioni aktual është jashtë kushteve optimale në funksionalitet.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë:

- 1-Projektin arkitektonik,
- 2-Preventiv punimesh,
- 3-Deklaratë për rimbursim TVSH-je
- 4-Çertifikatën e pronësisë ku mund të ndërtohet stacioni i ri

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KRYETARI  
NDREC DEDAJ**



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

Nr. 409 Prot

Rrëshen, më 29/01 /2024

Lënda: Kërkesë për transferim prone

Drejtuar: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË HEKURUDHAVE, DURRËS

Për dijeni: MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, TIRANË

I nderuar z. LIKO,

Duke qënë se Bashkia Mirditë është shpallur fituese e projektit "NDËRTIM I STACIONIT ZJARRËFIKËS", i cili do të financohet nga ODC (Office of Defence Cooperation) Ambasada Amerikane në Shqipëri si dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), ju informojmë që kemi hasur vështirësi në saktësimin e truallit për ndërtimin e objektit. Bashkia Mirditë ka në pronësi parcelat me nr pasurie 4/74 dhe 4/75 të ndodhura në Zona Kadastrale 3224, ku është planifikuar të vendoset objekti.

Gjatë inspektimit në terren nga grupi i projektimit konstatoi se rruga e aksesit për hyrjen në objekt kalon te pronat e sipërcituara, që janë në pronësinë Tuaj (D.P.TH) (konfirmuar edhe me inventarin e pasurive, Bashkia Mirditë). Pronat tuaja që preken nga ndërtimi i veprës tonë janë si vijon:

Nr. pas	Zona Kadastrale	Sipërfaqja që preket (m <sup>2</sup> )	Sipërfaqja e përgjithshme e pronës (m <sup>2</sup> )
4/62	3224	217	1376.7
4/11	3224	233	5851.1
4/61	3224	294	1145.5
4/56	3224	4 651	34124.7
		15 395	42 498

Duke qënë para faktit që aksesit në rrugë është i domosdoshëm për ne, si dhe projekti është në faza të avancuara kërkojmë nga ana Juaj:

3. Nëse mundet të na lejoni që të kemi akses të plotë në parcelat që ju keni në pronësi, për qarkullimin e mjeteve me qëllim hyrje – daljen e mjeteve zjarrëfikëse në objekt?
4. Transferimin e pronave të sipërcituara sipas sipërfaqeve të detajuara në tabelë.

Bashkëlidhur kërkesës sonë keni hartat e përpiluara për transferimin e këtyre pronave si dhe licencat e inxhinierëve hartues.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

KRYETAR  
Albert MËLXSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRËS

Lenda: Kthim Pergjigje

**Drejtuar: BASHKIA MIRDITE**

Në përgjigje të aplikimit tuaj Nr. datë 23.06.2023 dhe në përgjigje të shkresës Nr.408/1 Prot. Date 29.01.2024 me anë të të cilit kërkonti shtetërimin me kodin I3 ( informacion zyrtar ) ju bejme me dije se :

Pasuria me Nr.4/62 Vol.10 Fq.158 Zk.3224 me Sip. 1377 m<sup>2</sup>, e llojit (Trotuar) rezulton e afishuar në emër SHTËT.

Pasuria me Nr.4/11 Vol.11 Fq.2 Zk.3224 me Sip. 5851 m<sup>2</sup>, e llojit (Hekurudhë) rezulton e afishuar në emër SHTËT.

Pasuria me Nr.4/61 Vol.8 Fq.169 Zk.3224 me Sip. 1145 m<sup>2</sup>, e llojit (Trotuar) rezulton e afishuar në emër SHTËT.

Pasuria me Nr.255/1 Vol.3 Fq.29 Zk.2769 me Sip. 10160 m<sup>2</sup>, e llojit (Shesh) rezulton e afishuar në emër SHTËT.



Pasuria me Nr.4/56 Vol.11 Fq.68 Zk.3224 me Sip. 34125 m<sup>2</sup>, e llojit (Truall) rezulton e afishuar në emër SHTËT.

Pasuria me Nr.255/2 Vol.3 Fq.30 Zk.2769 me Sip. 2440 m<sup>2</sup>, e llojit (Shesh) rezulton e afishuar në emër SHTËT, kjo pasuri është mbyllur dhe ka vijuar në pasuritë:

1. Pasuria me Nr.255/4 Vol.3 Fq.62 Zk.2769 me Sip. 1009 m<sup>2</sup>, e llojit (Truall) rezulton e afishuar në emër të shoqëria " KALLI" SHPK.
2. Pasuria me Nr.255/5 Vol.3 Fq.63 Zk.2769 me Sip. 48 m<sup>2</sup>, e llojit (Truall) rezulton e afishuar në emër të shoqëria " KALLI" SHPK.
3. Pasuria me Nr.255/6 Vol.3 Fq.64 Zk.2769 me Sip. 1383 m<sup>2</sup>, e llojit (Truall) rezulton e afishuar në emër SHTËT.

**Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!**

**DREJTOR**

 Mariel Hoxha	 Paolo Baballeku	 Klajdi Dodaj
Digitally signed by: Mariel Hoxha Date: 2024.03.21 05:10:57 +02'00'	Digitally signed by: Paolo Baballeku Date: 2024.03.23 10:24:00 +02'00'	Digitally signed by: Klajdi Dodaj Date: 2024.03.23 12:49:33 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Zyra  
Vendore Mirditë  
Date: 2024/03/21 17:10:37 +02'00'  
K39004005V2024032117103091014

Dt. 09.02.24



ALBANIAN RAILWAYS

Nr. 113 / 1 prot.

Durrës, më 7.02.2024

**Lënda : Përgjigje shkresës Tuaj Nr.409 Prot, Datë 29.01.2024**

**Drejtuar : BASHKISË MIRDITË**

**z. Albert MELYSHI**

I nderuar z.Kryetar

Në lidhje me shkresën tuaj nr.409 datë 29.01.2024, me objekt "Kërkesë për Transferim prone". ju bëjmë me dije se kërkesa e Juaj duhet të dërgohet pranë Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, e cila është pronare e Hekurudhës Shqiptare sh.a.

Nga ana e Juaj, duhet të kërkohet pranë Ministrisë Pronare, në zbatim të ligjit 8744 datë 22.2.2001, dalje e një vendimi të qeverisë me objekt transferimin e pronës, me interes vendor, në pronësi të Bashkisë dhe për një ndryshim në Vendimin nr.120 date 04.03.2004 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e listës inventarit të pronave të paluajtueshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrative Ministrisë Transportit dhe Telekomunikacionit, të ndryshuar.

Hekurudha Shqiptare sh.a. është dakort për transferimin e pronës ku do të zhvillohet projekti i Bashkisë i emërtuar "Ndërtimi i Stacionit Zjarrfikës"

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin

**ADMINISTRATORI SHQIPËRISË**







# FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

Identifikoi: Dep. Teknik e Investimeve i D.P.Hekurudhave  
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Dep. Teknik e Investimeve i D.P.Hekurudhave  
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Drejtori Pergjithshem i Hekurudhave  
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, flet-firma vula)

Institucioni i Pushtetit Qendror:  
bashkia / Komuna: Rreshen

usha e perdorimit te prones: Hekurudha

A		B				C			
Zona Kadastra & Indeks i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vendndodhja/ Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te prones	Adresa /Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e prones ne m2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
				Stacioni Hekurudhor Rreshen					
			- Peroni		3480 m2	Per udhetare	D.P.H	D.P.H	
			- Rrethimi		2380 m2	Kufizimi	D.P.H	D.P.H	
			- Shesh i betonuar		7800 m2	Per mallra	D.P.H	D.P.H	
			-Estakade		150 ml	"	D.P.H	D.P.H	
			-Sheshi Estakades		8800 m2	"	D.P.H	D.P.H	
			-Shesh I asfaltuar		-	-	-	-	
			-Rruge		8000 m2	Rruge	D.P.H	D.P.H	
			-Linja vinçi		250 ml	Per mallra	D.P.H	D.P.H	
			-Linja te dyta		26160 m2	Linje	D.P.H	D.P.H	
			-Furniz. Energji		400ml	-	D.P.H	D.P.H	
			-Furniz me uje		100 ml	-	D.P.H	D.P.H	
			-Sheshi para godines udhetareve		340 m2	Per udhetare	D.P.H	D.P.H	
			-Sheshi bunkereve		2346 m2	Per mallra	D.P.H	D.P.H	